



RAPORTI I DHUNIMIT TË TË DREJTAVE TË KOMUNITETIT LGBT

Tiranë, Janar-Dhjetor 2012

© Ambasada PINK/LGBT Pro Shqipëri

Shkeljet e të drejtave të komunitetit LGBT, viti 2012

Raportuar pranë Ambasadës
PINK/LGBT Pro Shqipëri ose
monitoruar perms medias.

SHKURT 2012

⇒ RASTI “ANXHELA”

Më datë 22, *Anxhela*, një nga pjesëtarët më të njohura të komunitetit transgjinnor në vend, raporton pranë PE¹ dhunën dhe fyerjet e ushtruara mbi të nga 2 oficerë policie në Tiranë, në datë 21.02.2012.

Anxhela tregon se është shoqëruar me forcë nga 2 oficerë policie në Komisariatit 3 për verifikim, ku pasi e kanë mbajtur rreth 1 orë dhe e kanë ofenduar në mënyrë të vazhdueshme për shkak të pamjes së saj, e kanë lënë të lirë.

PE drejtoi Anxhelën pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të bërë ankesë ndaj 2 punonjësve të policisë.

MARS 2012

⇒ RASTI “SPAHIA”

Rasti më flagrant i diskriminimit dhe shprehjes së homofobisë ndaj komunitetit LGBT në vend gjatë këtij

¹ PE wshtw shkurtim i PINK Embassy (Ambasada PINK)

muaji, ishte deklarata e zv. Ministrit të Mbrojtjes z. Ekrem Spahia, e datës 23 Mars 2012 në gazetën Shqiptare dhe disa të përditshme të tjera², ku thuhej se komuniteti LGBT nëse do të dilte në manifestime do të “kapej në hu”, në të cilën ka përdor hapur gjuhën e urrejtjes dhe nxitjen e homofobisë.

PE reagoi menjëherë përmes një deklarate dërguar kryeministrit të vendit ku i kërkohej të merreshin masa të menjëhershme distancimi ndaj qëndrimit të zv.ministrit të qeverisë së tij.

Menjëherë pas deklaratës së PE, kryeministri në një koment të tij në mbledhjen e grupit të PD, ka thënë se deklaratat e zv/ministrit të Mbrojtjes, Ekrem Spahiu, janë të papranueshme dhe nuk tregojnë aspak qëndrimin mbretëror.³

Ndërkohë PE ka reaguar gjithashtu përmes debateve në median e shkruar dhe atë elektronike. Gjithashtu me iniciativën e PE u organizua edhe tryeza e rrumbullakët e shoqërisë civile në bashkëpunim me dy grupimet e tjera LGBT në vend, dhe me pjesëmarrjen e organizatave dhe institucioneve të të

2

<http://www.shqiptarja.com/aktualitet/2731/dru-gay-ve-spahia-s-nderron-mendje-lgtb-ne-burg-74664.html>

http://www.balkanweb.com/bw_lajme2.php?ID=Categoria=2685&IDNotizia=84839&res_start=0

<http://www.lezha.eu/parada-gay-shqiperi-ekrem-spahiu-ti-rrahim/>

³http://www.sot.com.al/index.php?option=com_content&vieë=article&id=26737:rama-le-ps-jashte-parlamentit-frike-nga-pazaret-e-deputeteve-&catid=34:politike&Itemid=60

drejtave të njeriut, nga e cila dolën një sërë rekomandimesh që duhet të zbatohen për respektimin e komunitetit LGBT në vend.⁴

Dy organizatat e tjera LGBT në vend bënë një ankesë të përbashkët pranë Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për deklaratat diskriminuese të zv. Ministrit. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi hapi hetimin ex UFFICIO për këtë çështje por pas disa muajsh çështja u mbyll për shkak të evidencave të pamjaftueshme.

Gjithashtu të dyja organizatat e çuan çështjen në Prokurori, pasi besohet se rasti është një dhunim i Kushtetutës dhe nenit 266 të Kodit Penal. Por prokuroria e mbylli çështjen me vendimin se nuk përbën një krim pasi nuk mund të vërtetohej që ky rast vinte në rrezik paqen sociale.

Çështja nuk u apelua pasi neni 266 i Kodit Penal i cili merrej si referencë nuk ishte i plotë.

Avokati i Popullit reagoi menjëherë pas deklaratës duke i kërkuar zv. Ministrit të kërkonte falje publike. Gjithashtu një sërë organizatash dhe institucioneve reagueshan duke i dënuar deklaratat e zv. ministrit, si Human Rights Watch, Ambasadori hollandez në Shqipëri, etc.

PRILL 2012

⇒ RASTI “PERLA”

4

<http://www.pinkembassy.blogspot.com/2012/04/tryez-diskutimi-shoqeria-civile-n.html>

Më datë 11.04.2012, paraqitet pranë PINK, *Perla* (pjestare e komunitetit transgjinnor), e cila raporton dhunën psikologjike, fizike dhe izolimin që ka pësuar në mënyrë të vazhdueshme nga i vëllai i saj 40 vjeçar për gati 5 muaj, që nga koha kur ai ka marr vesh për identitetin e tij gjinnor.

Ndërkohë rasti më i fundit i dhunës ka ndodhur vetëm një natë më parë, rreth orës 19.00, kur i vëllai pas një zënke e ka qëlluar me pëllëmbë dhe e ka nxjerrë në oborr gjithë rrobat e tij, duke i thënë se nëse largohet nga shtëpia nuk kthehet më në të. Megjithë kërcënimin e të vëllait *Perla* ka lënë shtëpinë dhe e ka kaluar natën tek një shoqe e saj.

Ajo tregon se në momentin e zënkës nuk ka pasur as reagimin as përkrahjen e 8 anëtarëve të tjerë të familjes dhe se ndihet e izoluar nga shoqëria dhe të afërmit.

PE pas bisedës që pati me të e këshilloi që të rikthehet në familje dhe të mundohet të flasë me qetësi me vëllain ku ti shpjegojë se është në moshë madhore dhe ka përgjegjësi të plotë për veten, ta bindë atë të ndryshojë mënyrën e të sjellurit dhe të komunikimit.

Gjithashtu e këshilloam që të flasë me anëtarët e tjerë të familjes që e mbështesin ose janë më të afërt me të si nëna apo vëllai më i vogël jo vetëm për ti pasur aleatë por edhe për të folur më vëllain e madh dhe për ta bindur atë të ndryshojë sjellje dhe qëndrim ndaj saj.

U këshillua që në rast të ndonjë zënke tjetër të na kontaktonte. *Perla* u kontaktua edhe një ditë më pas nga PE dhe na komunikoi se ishte kthyer në

shtëpi dhe gjithçka kishte shkuar mirë, situata familjare i është kthyer normalitetit dhe qetësisë.

Gjithsesi ky rast dhe te tjera, mbase të paraportuara formalisht por të njohura përmes bisedave gjatë aktiviteteve, tregojnë se komuniteti LGBT në vend vazhdon të jetojë nën presionin e dhunën e vazhdueshme fizike dhe emocionale të familjarëve të tyre për mohimin dhe fshehjen e identitetit gjinor apo orientimit të tyre seksual.

MAJ 2012

⇒ RASTI I DEBATEVE MBI PARADËN LGBT

Gjatë muajit Prill dhe Maj 2012, në kuadër të debatit të hapur në media për aktivitetet e 17 Majit – Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, pati një seri rastesh të kërcënimit, paragjykit, diskriminimit dhe shprehjes së hapur të homofobisë ndaj komunitetit LGBT në median e shkruar dhe vizive, blogosferë, media sociale, nga përfaqësues të partive politike, grupime fetare, figura të njohura publike në vend dhe qytetarë të thjeshtë.

Z. Murat Basha, nën kryetar i Partisë së Legalitetit, i drejtohet në një emision live në TV KLAN një aktivisti LGBT, me fjalët “të pres gurmazin” , çka përbën një kërcënim të hapur të këtij komuniteti nga figura të njohura publike.⁵

⁵

<http://www.youtube.com/watch?v=sLY46IcEV58>

http://www.sot.com.al/index.php?option=com_content&view=article&id=27815:murat-basha-

Z. Ekrem Spahia, kryetar i Partisë së Legalitetit, ka reaguar publikisht në media ndaj Ambasadorit Holandez në vendin tone, Henk van den Dool, i cili njihet si mbështetës i komunitetit LGBT, duke kërkuar që ai të shpallet *persona non-grata*, ndërkohë që aktivitetet e 17 Majit i ka cilësuar si të dëmshme për moralin e shoqërisë sonë.⁶

Një grup myslimanësh protestojnë më 17 Maj, kundër aktiviteteve të organizuara në kuadër të kësaj dite nga Ambasda Pink dhe mbështetës të komunitetit LGBT me sloganet “Pro familjes, pro moralit, pro jetës”⁷,

Të gjitha këto raste dëshmojnë për frymën homofobike që ekziston në shoqërinë tonë aq më tepër nga figura të njohura publike.

⇒ RASTI “A.A.”

Më datë 24.05.2012, paraqitet pranë PE, A.A., 28 vjeç nga Tirana, i cili raporton dhunën fizike dhe psikologjike ushtruar mbi të nga vëllai më i madh si edhe dëbimin nga shtëpia që i është bërë prej tij, pasi e ka parë në TV në një nga aktivitetet e organizuara nga dy grupime LGBT në kuadër të aktiviteteve të datës 17 Maj.

Po atë ditë, në darkë një pjesë e mediave (konkretisht 5 TV) e kanë

[kercenon-kristi-pinderin-me-prerje-gurmazi-ne-emisionin-e-fevziut&catid=219:politike-gazeta&Itemid=466](http://www.kercenon-kristi-pinderin-me-prerje-gurmazi-ne-emisionin-e-fevziut&catid=219:politike-gazeta&Itemid=466)

⁶

<http://www.shqiperia.com/lajme/lajm/nr/16257/Ambasadori-holandez-U-surprizova-nga-Spahia>

⁷

<http://www.gazetatema.net/ëeb/2012/05/16/muslimanet-proteste-ndaj-homoseksualeve-nete-njeten-ore-me-paraden-e-gay-ve/>

nxjerrë djalin me fytyrë dhe me flamurin LGBT në dorë. Duke mos pasur asnjë lloj ndihme dhe mbështetje tjetër pas dëbimit nga shtëpia, djali paraqitet pranë zyrave tona ku raporton rastin dhe kërkon mbështetje.

Ambasada Pink pasi interviston A.A dhe kryen të gjitha procedurat e nevojshme të raportimit të rasteve të dhunës, e këshillon për një bisedë tjetër me prindërit dhe të afërmit të cilët e mbështesin, si edhe për denoncim të të vëllait në polici pasi ka ushtruar dhunë mbi të.

Gjithashtu PE fillon procedurat për akomodimin e tij në strehëzën e emergjences për komunitetin LGBT “Strehëza e Ylberit”, si edhe e asiston për gjetjen e një pune⁸.

Ndërkohë po atë ditë A.A na komunikon se është kthyer në shtëpi për të folur me të afërmit edhe njëherë dhe se gjithçka ishte zgjidhur dhe tashmë qëndron përsëri në shtëpi.

Ky rast dëshmon se komuniteti LGBT në vend edhe në rastet kur i ka bërë prezente familjes orientimin seksual e në një farë mënyre është pranuar prej tyre, përsëri dhunohet psikologjikisht nga të afërmit për mbajtjen fshehur të orientimit të tyre seksual, për të mos u bërë publik për shkak të opinionit shoqëror.

KORRIK 2012

⇒ RASTI “D.P”

⁸ Aplikimi dhe marrëveshja e akomodimit të qendra e emergjencës së PE. Dokumenti i disponueshëm nga PE.

Më datë 11.07.2012, paraqitet pranë PE, D. P. një djalë 21 vjeç nga një qytet i veriut të Shqipërisë, i cili raporton konfliktin me familjarët për shkak të orientimit të tij seksual.

Më konkretisht D.P nuk pranohet dhe kërcënohet nga i vëllai i tij më i madh i cili e dhunon psikologjikisht pasi është vënë në dijeni për orientimin e tij seksual.

Gjithashtu i vëllai ka ndërprerë edhe ndihmën financiare që i jepte D. për vazhdimin e studimeve të larta. Për këtë arsye D. nuk ka mundësi të vazhdojë më shkollën dhe është detyruar të largohet nga shtëpia duke u zhvendosur në Tiranë tek një shoqja e tij.

PE i sugjeron D. të gjejë një formë bashkëbisedimi me të vëllain dhe e asiston për gjetjen e një pune, formim profesional dhe vazhdimin e shkollës.

Por deri tani D. nuk ka mundur të kontaktojë vetë me të vëllain, ndërmjetëse mes tyre është e ëma.

Gjithashtu D. vazhdon të jetojë i vetëm në Tiranë larg familjarëve të tij. D. frekuenton aktivitetet e Ambasadës PINK dhe mban kontakte të vazhdueshme me stafin e PE.

TETOR 2012

⇒ RASTI I DHUNËS DHE KËRCËNIMEVE ME VDEKJE NDAJ AKTIVISTËVE LGBT NË VEND

Më datë 24 Tetor 2012, një grup aktivistësh nga tre organizatat LGBT në Shqipëri, Aleanca kundër Diskriminimit LGBT, Ambasada PINK / LGBT Pro

Shqipëri dhe Të bashkuar pro Kauzës LGBT manifestuan paqësisht përballë Ambasadës së Republikës së Maqedonisë në Tiranë për të dënuar aktet e dhunës dhe diskriminimit e hapur ndaj aktivistëve LGBT dhe kësaj çështje në vendin fqinj.

Pas protestës, teksa grupi i aktivistëve po shkonte të ulej në një kafe aty pranë, një person, rreth 25 vjeç, i quajtur Redon Maloku u afrua pranë grupit duke i sulmuar verbalisht me fjalë denigruese, përshtyrë dhe kërcënuar⁹. Grupi i aktivistëve reagon duke lajmëruar policinë e cila pak minuta më vonë erdhi në vend ngjarje.

Edhe pse kjo situatë u duk sikur ishte sporadike, në fakt pak minuta më vonë, disa nga aktivistët e njohën këtë emër si atë të një personi i cili është aktiv me komunitetin mysliman në Shqipëri dhe është po ashtu një nga personat që është marrë me organizimin e protestave kundër komunitetit LGBT në datën 17 Maj 2012.

Dhunuesi u dërgua në Komisariatin e Policisë ku u intervistua dhe u kryen të gjitha procedurat e nevojshme dhe pas disa orësh u lirua për tu gjykuar në gjendje të lirë. Aktivistët LGBT bënë denoncimin ndaj rastit dhe të treja organizatat reagon përmes një deklarate të përbashkët për shtyp ku shprehën vendosmërinë e tyre për ta ndjekur çështjen në rrugë ligjore sepse vetëm përmes ligjit mund të parandalosh atmosferën kërcënuese që rrezikon respektimin e të drejtave themelore të njeriut.

⁹ <http://historia-ime.com/en/2011-08-07-02-59-53/item/619-incident-me-aktivistet-lgbt-te-rruga-e-ambasadave-foto.html>

DHJETOR 2012

⇒ RASTI E.A

Më 19 Dhjetor 2012, E.A. 22 vjeç, raporton pranë PE për dhunën dhe persekutimin e vazhdueshëm që i bëhej praj gati 3 muajsh nga një grup prej 5-6 djemsh të rinj të panjohur për të.

Ndjekja dhe dhunimi kishin filluar kur grupi i djemve kishin parë E.A. të puthej me partnerin e tij në një park. Në këtë moment ata e kishin ofenduar e dhunuar fizikisht dhe me armë e kishin detyruar të zhvishej dhe e kishin filmuar me vidjo. Më pas e kishin lënë të largohej dhe e kishin ndjekur për të mësuar vendbanimin e tij.

Pas kësaj grupi i djemve kishin shkuar disa herë afër vendbanimit të E.A. duke e kërcënuar dhe shtyrë me forcë në tokë.

PE e këshilloi dhe orientoi djalin të denonconte rastin në polici dhe pranë Institucionit të Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Nga djali u bënë përpjekjet për ta denoncuar rastin në polici por policia nuk e pranoi denoncimin pasi dhunuesit ishin të panjohur për djalin dhe të paidentifikueshëm për policinë. Pas kësaj djali e raportoi rastin edhe pranë KMD por edhe nga ky institucion u përmend vështirësia për identifikimin e autorëve përse kohë ata ishin të panjohur për djalin.

⇒ RASTI L.K

Më 19 Dhjetor 2012, L.K. një anëtar i komunitetit transgjinnor në vend raporton pranë PE dhunën psikologjike dhe fizike ushtruar mbi të dhe dy shokë

të tij nga 4 djem dhe vajza të rinj të panjohur për L.K.

Ngjarja ndodhi në një klub nate në kryeqytet ku L.K. ndodhej së bashku me dy shokë. Atje, grupi i vajzave dhe djemve filloi ta ngacmonte dhe ofendonte L.K. me fjalë që cënonin identitetin e tij gjinor. Pas kësaj të dy grupet patën një zënkë me njëri-tjetrin dhe L.K. së bashku me miqtë e tij u rrafën nga grupi i të rinjve të panjohur.

Viktima deklaroi se policia mbërriti në vendngjarje 10 minuta pas zënkës dhe se e neglizhoi situatën duke thënë se 'ne kemi shumë raste si këto në ditë'. Viktimat u larguan pa patur mundësinë e denoncimit sepse ata u ndjenë të ofenduar nga sjellja e policisë.

FUND

Dhjetor 2012